



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura IV**  
**Sesioni Pranveror**

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor**

Mbledhja nr. 5

Prishtinë, më 3.5.2011, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

**P R O C E S V E R B A L**

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Rasim Demiri, Afërdita Berisha-Shaqiri, Daut Haradinaj, Salih Morina, Sevdije Lama.

Munguan : Liburn Aliu, Nijazi Idrizi, Etem Arifi.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : zyrtarë, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar.

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit dt. 12.4.2011 dhe raportit nga takimi dyditor në Dragash.
3. Shqyrtimi, në parim, i Projektligjit për ndryshim e plotësim të ligjit nr. 2002/5 për themelimin e regjistrit të drejtave pronës së paluajtshme.
4. Shqyrtimi, në parim, i projektligjit për Kadastër.
5. Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Tokat bujqësore.
6. Detajizimi i planit të punës së komisionit sipas afateve tremujore për projektligjet që do të dërgohen nga Qeveria.
7. Të ndryshme.

**Kryetari** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

**2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 12.4.2011 dhe raportit nga takimi dyditor i komisionit në Dragash**

**Kryesuesi** konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar pa ndonjë vërejtje, ndërkaq raporti për takimin e komisionit në Dragash u sugjerua të përfshijë diskutimet në tërësi pasi janë cekur disa (vërejtja e Salih Morinës). Stafi do të përfshijë diskutimet në tërësi nga ky takim deri në mbledhjen e radhës kur do të miratohet raporti.

### **3. Shqyrtimi, në parim, i Projektligjit për ndryshim e plotësim të ligjit nr. 2002/5 për themelimin e regjistrit të drejtave pronës së paluajtshme**

Kryesuesi **Nait Hasani** hapi diskutimin lidhur me këtë projektligj. Disa anëtarë të komisionit parashtruan disa çështje siç ishte **Afërdita Berisha** lidhur me kategorizimin e tatimeve nëpër Komuna, pse diku janë më të ulëta dhe diku më të larta. **Salih Morina** ishte i mendimit se Komuna me rregullore nuk e bënë caktimin e tarifës për pronën për shkak se ajo është kompetencë qendrore (MEF) sipas rregulloreve të brendshme, derisa **Nait Hasani** ishte i mendimit se këto tatime ndahen në disa kategori, megjithatë ai sugjeroi që komisioni sot të miratojë këtë projektligj në parim dhe të përcjelli atë në mbledhje plenare me këtë rekomandim, i cili u miratua unanimisht :

#### **R e k o m a n d i m**

Të miratohet në parim, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2002/5 për themelimin e regjistrit të drejtave të pronës së paluajtshme.

### **4. Shqyrtimi, në parim, i projektligjit për Kadastër**

**Nait Hasani** gjithashtu edhe për këtë projektligj i propozoi komisionit miratimin në parim i cili gjatë mbledhjes plenare do të ketë mundësi të shqyrtohet me ndonjë pyetje eventuale nga deputetët drejtuar ministrit të mjedisit, ndaj unanimisht u vendos si vijon :

#### **R e k o m a n d i m**

Të miratohet në parim, Projektligji për Kadastër.

### **5. Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Tokat bujqësore**

**Nait Hasani** fillimisht sqaroi për mbikëqyrjen e këtij ligji i cili ka filluar në legjislacionin e kaluar por edhe tani duhet të vendos komisioni për këtë mbikëqyrje dhe të caktohet grupi mbikëqyrës, i cili grup pastaj mblidhet për të definuar detyrat vijuese lidhur me këtë mbikëqyrje, ndaj komisioni nxori këtë :

#### **P Ë R F U N D I M**

**I. Fillon mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Tokën Bujqësore, me mbështetjen e OSBE.**

**II. CAKTOHET grupi punues si vijon : Nijazi Idrizi-kryesues dhe anëtarët Daut Haradinaj, Afërdita Berisha dhe Sevdije Lama.**

**III. Grupi punues do të takohet më 5 maj në pauzën e parë të mbledhjes plenare për të rishikuar fillimin e mbikëqyrjes në legjislacionin e kaluar (saktësimin e pyetësorit etj) dhe bashkërenditur detyrat rreth mbikëqyrjes së këtij ligji-hartimin e planit operativ.**

## 6. Detajizimi i planit të punës së komisionit sipas afateve tremujore për projektligjet që do të dërgohen nga Qeveria

**Nait Hasani** sqaroi për komisionin se plani i punës është dashur të konkretizohet gjatë takimit dyditor në Brod , ngase shumica e projektligjeve me gjasë do të arrijnë në një periudhë të ngushtë kohore (maj-qershor), ndaj periudha e shqyrtimit të tyre është ndarë sipas afateve tremujore, të cilat do të pasqyrohen në mënyrë tabelore nga stafi i komisionit dhe do të dorëzohet komisionit. Ai gjithashtu njoftoi se është kërkuar nga ministrinë përkatëse të sjellën projektligjet që janë prioritet i raportit të progresit.

## 7. Të ndryshme

**1. Nait Hasani** njoftoi për interesimin e këtij komisioni për një debat parlamentar për Pyjet, por paraprakisht propozoi që të ftohen zyrtarët e APK dhe Departamentit të Pyjeve të ministrisë për të njoftuar komisionin me gjendjen reale në teren dhe si do të ishte mbrojtja më e mirë e pyjeve. Pas këtij takimi komisioni do të krijoj një qëndrim të qartë për veprimet që duhet të ndërmerren rreth mbrojtjes së pyjeve, për një ligj të ri me modelin e ndonjë shteti me përvojë (Austri apo ndonjë shteti) etj. Takimi do të mbahet në javën e ardhshme, ku komisioni pas këtyre njoftimeve do të vendos rreth kërkesës për një debat parlamentar.

**2.** Në vazhdim kryesuesi **Nait Hasani** njoftoi komisionin me një raport-statistikë të dërguar nga komuna e Rahovecit rreth dëmeve të shkaktuara në vreshtari nga dimri që mbretëroi (moti i ligë) ku flitet për dëme të konsiderueshme që janë shkaktuar në shumë prej 4 milion e 800.000 eurosh, ndaj kërkohet nga ky komision të dërgoj Qeverisë dhe ministrisë përkatëse një raport rreth një kompensimi të mundshëm. Pasi që kryesuesi pyeti komisionin rreth këtij intervenimi të komisionit **Daut Haradinaj** tha se nuk ka asgjë kundër dhe kjo kërkesë duhet të bëhet sa më shpejtë. **Afërdita Berisha** insistoi se kjo kërkesë duhet të përfshijë edhe komunat tjera ku janë bërë dëmet e cekura (Suhareka etj), ndërsa **Sevdije Lama** shtoi që të përfshihen edhe kulturat tjera që janë dëmtuar, përveç vreshtave. **Salih Morina** tha se kjo kërkesë mund të bëhet nëse kemi paraprakisht një raport nga departamenti i caktuar në ministrinë e bujqësisë rreth dëmeve të shkaktuara në Kosovë në periudhën kur janë shkaktuar këto dëme-periudha e dimrit që kaloi. Kryesuesi **Nait Hasani** arsyetoi kërkesën e tij për Rahovec ngase vetëm nga ajo komunë ka ardhur kërkesa, por nuk kundërshtoi kërkesat e parashtruara në vazhdim, ndaj **Komisioni vendosi që të kërkohet nga departamenti përkatës përmes sekretarit në ministrinë e bujqësisë, raporti për dëmet e shkaktuara në Kosovë ashtu si u saktësua më lartë.**

**3.** Njoftimi i fundit i kryesuesit ishte rreth një takimi që do të mbahet nga NDI në grykën e Deçanit për Pyje, për datën 16 maj në Deçan, për të cilin takim duhet të përgatitet transporti nga Kuvendi. Në këtë takim ftohet komisioni komplet.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 12,15.

Kryetari i Komisionit,  
**Nait Hasani**